



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 09 Qershor 2021

Nr: 386

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Valbona Zeka me funksion Shef i Departamentit të Përgatitjes Fizike në Akademinë e Forcave të Armatosura

Kërkues: Qytetar

Ndaj: Zj. Valbona Zeka, Shef i Departamentit të Përgatitjes Fizike në Akademinë e Forcave të Armatosura

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n’, pika 2 dhe 63, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:



Data: 09 Qershor 2021
Nr. 386

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Valbona Zeka, Shef i Departamentit të Përgatitjes Fizike në Akademinë e Forcave të Armatosura

I.

Vlerësimi paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1456 prot., datë 22.04.2021, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4277 prot., datë 22.04.2021, nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sekretari i Përgjithshëm zj. Ornela Zonja, është përcjellë denoncimi i mbërritur në mënyrë shkresore pranë këtij institucioni nga z. Indrit Leka.

Në këtë denoncim pretendohet se *“Në Akademinë e Forcave të Armatosura, në Ministrinë e Mbrojtjes, zj. Valbona (Taullaj) Zeka, Shefe e Departamentit të Përgatitjes Fizike, është regjistruar si kandidate për parlament nën siglën e PSD-së. Zonja, jo vetëm që nuk ka paraqitur kërkesën për t’u pezulluar, por vazhdon punë haptazi në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, Kodin e Punës dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por ka edhe mbrojtjen nga të gjithë nënpunësit e Ministrisë, kuptohet me urdhër nga lart. Kjo duhet se s’bën të mbështesë Tom Doshin. Zonja në fjalë është zonja që u ndalua duke vjedhur ndihma së bashku me bashkëshortin polic ne Rinas, gjatë kohës së karantinës.”*

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Referuar nenit 7 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me



zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj zj. Valbona Zeka ndaj të cilës atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

II.

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ, më datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 *“Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*. Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020. Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në denoncimin e raportuar pretendohet se zj. Valbona Zeka, me funksion Shef i Departamentit të Përgatitjes Fizike në Akademinë e Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes, në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, është regjistruar si kandidat për deputet nën siglën e subjektit zgjedhor PSD.

Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 1456 prot., datë 22.04.2021, ka vënë në dijeni Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Ministrinë e Mbrojtjes, mbi denoncimin e përcjellë pranë këtij institucioni. Me marrjen dijeni, zj. Zeka ka dërguar një shkresë përcjellëse protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 5606 prot., datë 01.06.2021, ku na ka vënë në dispozicion korrespondencën me këtë institucion.

Zj. Valbona Zeka ka dhënë pretendimet e saj duke vënë në dispozicion shkresën me nr. 1413/1 prot., datë 23.04.2021, me lëndë kthim përgjigje nga Komandanti Gjeneral Brigade z. Albert Mullai ku sqarohet se, *“Akademia e Forcave të Armatosura bazuar në kërkesën e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë me nr. 259, datë 26.03.2021 “Kërkesë për miratim leje të zakonshme, personelit civil”, për periudhën 29.03.2021-25.40.2021 me urdhër të Komandatit të Akademisë së Forcave të Armatosura nr. 105, datë 31.03.2021,*



zj. Valbona Zeka, sipas kërkesës së saj është trajtuar me lejen e zakonshme vjetore të paguar. Për sa i përket pretendimit për moszbatimin e vendimit nr. 9, datë 20.12.2020, ju informojmë se, Akademia e Forcave të Armatosura është mbështetur në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, neni 63 i tij i cili përcakton shprehimisht se cilat kategori nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen pa hequr dorë më parë nga detyra. Zj. Valbona Zeka nuk bën pjesë në kategoritë e listuara.

III.

Analiza ligjore

Në nenin 63, pika 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se, “*Përveç kushteve të parashikuara në pikën 3, nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen pa hequr dorë më parë nga detyra:*

- a) gjyqtarët, prokurorët;*
- b) ushtarakët e shërbimit aktiv;*
- c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar;*
- ç) përfaqësuesit diplomatikë;*
- d) kryetarët e bashkive për zgjedhjet në Kuvend;*
- dh) deputetët, kur konkurrojnë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore;*
- e) prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre për zgjedhjet në Kuvend dhe për organet e qeverisjes vendore;*
- ë) kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve;*
- f) Presidenti i Republikës;*
- g) zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj.*

Vendimi nr. 9 datë 24.04.2020 i Komsionit Rregullator, në nenin 3 pika 2 të tij, ka përcaktuar rrethin e subjekteve që kanë detyrimin për të respektuar këtë vendim. Përkatësisht ky nen parashikon se “*Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zoteron aksione e kapitale/kuota apo emeron shumicën e organit mbikqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë*



periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në fjarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi. Po ky vendim në pikën 2, të nenit 6, përcakton se “Punonjësi i administratës shtetërore i cili është i regjistruar si kandidat për zgjedhjet pezullohet nga detyra nga momenti i regjistrimit të tij si kandidat deri në datën e përfundimit të numërimit të votave në zonën ku kandidon. Për nëpunësit, marrëdhënia e punës të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës, në rastet kur nuk njoftojnë për kandidimin në zgjedhje, merret masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.”

Në denoncimin e mësipërm, zj. Valbona Zeka mban pozicionin e Shefit të Departamentit të Përgatitjes Fizike në Akademinë e Forcave të Armatosura, pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe marrëdhënia e saj e punës rregullohet me Kodin e Punës. Akademia është institucion i arsimit të lartë i profilizuar, që vepron në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. Përkatësisht Akademia e Forcave të Armatosura është një institucion i arsimit të lartë i cila organizon dhe drejton përgatitjen, arsimimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të oficerëve, nënoficerëve dhe civilëve, përpunon dhe përshtat koncepte doktrinale bazë të organizimit dhe të përdorimit të forcave të armatosura, në përputhje me strategjinë e sigurimit, politikën e mbrojtjes dhe strategjinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë, përmirëson në vazhdimësi programet, standardet dhe kërkesat për stërvitjen e ushtarit profesionist, të nënrepartëve, repartëve e njësisë, në interes të rritjes së aftësive luftarake të Forcave të Armatosura. Institucionet e arsimit të lartë rregullohen me ligj të posaçëm, përkatësisht me ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3, pika 1, e këtij ligji përcakton se institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, **autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit**, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës për t’u **vetëqeverisur**, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi. Gjithashtu, këto institucione caktojnë në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.

Sipas denoncimit, zj. Valbona Zeka është regjistruar si kandidat për deputet në zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021 pa paraqitur kërkesën për pezullim nga detyra. Referuar ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Akademia e Forcave të Armatosura është institucion arsimor që ka autonomi financiare, organizative dhe në përzgjedhjen e personelit. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë janë



institucione që realizojnë programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor të kësaj akademie. Funkzioni rregullator i shtetit nuk e bën Akademinë e Forcave të Armatosura institucion varësie të Ministrisë së Mbrojtjes dhe as punonjësit e këtij institucioni, administratë të tij. Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator përcakton detyrimin e pezullimit nga detyra të kandidatëve për deputetë **që janë punonjës së administratës shtetërore**, qoftë këta punonjës marrëdhënia e të cilëve rregullohet me ligjin për nëpunësin civil apo me Kod Pune.

Të ndodhur në këto kushte, punonjësit e arsimit të lartë nuk konsiderohen punonjës së administratës shtetërore pasi marrëdhënia e tyre e punës, organizimi dhe përzgjedhja rregullohen me ligj të veçantë. Akademia e Forcave të Armatosura është institucion publik i pavarur dhe si i tillë marrëdhënia e punëve nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Si rrjedhojë, zj. Zeka nuk ka pasur detyrimin për të kërkuar pezullimin nga detyra dhe as detyrimin për të hequr dorë nga ushtrimi i detyrës.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezultoi e provuar se zj. Valbona Zeka, është në shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, kandidimi i zj. Valbona Zeka, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n’, pika 2 dhe 63, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,



V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj zj. Valbona Zeka, pasi nuk konstatohen shkelje vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 09 Qershor 2021
Nr. 386

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Valbona Zeka, Shef i Departamentit të Përgatitjes Fizike në Akademinë e Forcave të Armatosura